



Kërko ...

[Kreu](#) [Rreth Nesh](#) [Struktura](#) [Projekte](#) [Multimedia](#) [Njoftime](#) [Transparenca](#) [Kontaktet](#)

Deklaratë për garën e zhvilluar për njërin prej 3 loteve të projektit të Unazës së Madhe të Tiranës segmenti Pallati me Shigjeta-Sheshi Shqiponja

Postuar më 07/12/2018

Autoriteti Rrugor Shqiptar u vu në dijeni të materialit të transmetuar mbrëmjen e djeshme në emisionin "Të Paekspozuarit" në televizionin News 24 për garën e zhvilluar për njërin prej 3 loteve të projektit të Unazës së Madhe të Tiranës, segmenti Pallati me Shigjeta-Sheshi Shqiponja.

Në kuadër të transparencës ndaj opinionit publik, Autoriteti Rrugor Shqiptar sqaron sa vijon:

Procedura e prokurimit është zhvilluar në përputhje me ligjin Nr.9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, VKM-së Nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik" e ndryshuar. Kjo procedurë bazuar në detyrimet ligjore të mësipërme, është procedurë e hapur, e zhvilluar në mënyrë elektronike përmes Agjencisë së Prokurimeve Publike.

Autoriteti Kontraktor ka nënshkruar kontratën me bashkimin e përkohshëm të operatorëve ekonomik "Biba X shpk" dhe "DH Albania sh.p.k. – degë e shoqërisë së huaj", pasi ka konstatuar që dokumentet janë në përputhje me kriteret e dhëna në dokumentet e tenderit. Operatori ekonomik "DH Albania sh.p.k. – degë e shoqërisë së huaj", pjesë e këtij bashkimi, ka paraqitur dokumentacionin të përkthyer dhe të noterizuar në gjuhën shqipe, ku kompania mëmë "Dunwell Haberman" rezulton e regjistruar dhe ushtron aktivitetin në një prej shteteve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, konkretisht në shtetin Delaware.

Në përmbushje të kriterëve të dhëna në dokumentet e tenderit ka bërë regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Bizneseve dhe njësimin e licencës duke respektuar Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.42 datë 16.01.2008, "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi". Njësimi i saj ka konkluduar me një nivel maksimal të licensimit, bazuar në veprimtarinë ekonomike të saj në vendin e origjinës, duke mbajtur kategoritë maksimale (kategoria G).

Autoriteti Rrugor Shqiptar nuk ka pasur ndonjë indicie që vë në dyshim vërtetësinë e dokumenteve të paraqitura, e cila do mund të çonte në një procedurë verifikimi paraprak.

Kontrata e nënshkruar me këtë bashkim operatorësh në fjalë për këtë lot të Unazës nuk ka prodhuar asnjë efekt financiar për Buxhetin e Shtetit.

Në funksion të sqarimit të plotë të situatës dhe pretendimeve të shfaqura në emisionin "Të Paekspozuesit", janë ndërmarrë këto veprime:

1. ARRSH i është drejtuar institucioneve që përmes komunikimit me rrugë zyrtare t'u kërkohej autoriteteve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës për të verifikuar dokumentet e paraqitura në institucionet shqiptare nga kompania në procedurën e garës.
2. Deri në sqarimin e situatës dhe përgjigjen nga autoritetet amerikane nuk do të vijohet me aktivitetin ndërtimor të kësaj kompanie për lotin Nr.1 të segmentit, që shtrihet nga Ura e Lanës deri tek Mbikalimi i Sheshit Shqiponja.
3. Në rast se autoritetet amerikane do të konfirmojnë zyrtarisht pretendimet për falsifikime dokumentacioni nga kjo kompani, në zbatim të përcaktimeve ligjore, Autoriteti Rrugor Shqiptar do të zgjidhë kontratën në mënyrë të njëanshme dhe do të ndjekë procedurat e tjera të përcaktuara në ligj. Në rast të zgjidhjes së kontratës, ARRSH do të rifillojë menjëherë procedurat e prokurimit për këtë lot për të mundësuar përfundimin në kohë të këtij projekti të rëndësishëm për kryeqytetin.

Autoriteti Rrugor Shqiptar garanton opinionin publik se është i vendosur të mbrojë maksimalisht interesat e shtetit shqiptar duke zbatuar përcaktimet ligjore për çdo situatë të tillë.

Njoftimet e Fundit

Inspektim punimesh në Elbasan-

Banjë Loti 3 22/10/2019

Përfunduan punimet e fazës së dytë

të rehabilitimit në Qafë Llogara

pjesë e aksit Llogara-Sarandë

22/10/2019

Lajmërim për shpronësim,

rrethrotullimi në hyrje të qytetit

Korçë 11/10/2019



This entry was posted in [Njoftime Flash](#), [Njoftime per Median](#), [Njoftime te Ndryshme](#). Bookmark the [permalink](#).

ARRSH

Kreu

Bordi

Drejtori Përgjithshëm

Zëvendës Drejtori i Përgjithshëm

Aplikime Prane ARRSH

Formular Aplikimi Për Shpronësime për

Interes Publik

Formular Aplikimi Për pajisjen me

Autorizim

Multimedia

Galeria

Njoftime per Median

Kontakte

Kontaktet

© Autoriteti Rrugor Shqiptar 2014 - 2019 - Të gjitha të drejtat e rezervuara. | Mundësuar Nga Albania